



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 54**

**Datë 21 prill 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 201, datë 9.4.2014	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të një anëtari të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.....	2121
Vendim i KM nr. 202, datë 9.4.2014	Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve për eksportuesit për qëllim të rimbursimit të TVSH-së .....	2121
Vendim i KM nr. 203, datë 9.4.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”, të ndryshuar..	2121
Vendim i KM nr. 204, datë 9.4.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, fazat I dhe II, në Bashkinë e Shkodrës .....	2122
Vendim i KM nr. 205, datë 9.4.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe ndërtimi i unazës veriore, segmenti A-B në lagjen “11 Nëntori”, hapja dhe sistemimi i zgjatimit të unazës së brendshme, segmenti që bashkon rrugën “28 Nëntori” me rrugën “Rinia”, si dhe hapja e sistemimi i zgjatimit të rrugës “Lef Nosi”, lagja “5 Maji”, segmenti B-C, të Bashkisë së Elbasanit .....	2123
Vendim i KM nr. 206, datë 9.4.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë, deri në depon e re, Arapaj, loti III)”	2126

Vendim i KM nr. 209, datë 9.4.2014	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të sigurisë në anije dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë” .....	2127
Vendim i KM nr. 210, datë 9.4.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1015, datë 27.11.2013 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, objekte, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare Ujë i Ftohtë-Tuneli, Bashkia Vlorë”.....	2129
Vendim i KM nr. 213, datë 9.4.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për përfaqësimin e Shqipërisë në bienalen e arkitekturës, që do të mbahet në Venecia, Itali, në periudhën 7.6.2014-23.11.2014.....	2130
Vendim i KM nr. 214, datë 9.4.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar .....	2130
Udhëzim i MF, MAS nr. 4, datë 11.3.2014	Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme” për federatat sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar .....	2130

**VENDIM**  
**Nr. 201, datë 9.4.2014**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË BORDIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Znj. Elira Kokona, anëtar i bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues i institucioneve të administratës qendrore, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Albana Koçiu emërohet anëtar i bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues i institucioneve të administratës qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 202, datë 9.4.2014**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE PËR EKSPORTUESIT PËR QËLLIM TË RIMBURSIMIT TË TVSH-së**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5 të nenit 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin si eksportues, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, të personit të tatueshëm:

a) Që eksporton sipas kuptimit të neneve 181 dhe 182 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

b) Nëse vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën më shumë se 60% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;

c) Nëse ka tepriçë kreditore, që tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë.

2. a) Eksportues me risk zero është personi i tatueshëm eksportues, sipas pikës 1, që plotëson kushtet e mëposhtme:

i) Vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën 100% të vlerës së përgjithshme të shitjeve;

ii) Ka aktivitet eksportues mbi dy vjet;

iii) Paraqet si dokument prove të kryerjes së eksportit, deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;

iv) Nuk ka detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

b) Për personat e tatueshëm, të klasifikuar me risk zero, sipas kësaj pike, miratimi i rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore bëhet pavarësisht nga kontrolli tatimor, i cili mund të kryhet në çdo moment, sipas planifikimit për kontroll. Procedura e rimbursimit kryhet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008, të ministrit të Financave “Për TVSH-në”, të ndryshuar.

3. Eksportuesi, që nuk plotëson kushtet e pikës 2 të këtij vendimi, rimbursohet për TVSH-në brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, të ministrit të Financave “Për TVSH-në”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 203, datë 9.4.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-së PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGINË ELEKTRIKE TË IMPORTUAR NGA KESH SHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pikat 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.5, 12.6 e 12.7 të kreut I/I të vendimit nr. 559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për skemën e shtyrjes së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH sh.a.”, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Procesi i kompensimit të detyrimeve për kërkesat e protokolluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të pranuar prej saj, të përfundojë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 204, datë 9.4.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,  
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN  
NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE,  
FAZAT I DHE II, NË BASHKINË E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, fazat I dhe II, në Bashkinë e Shkodrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Shkodrës.

**TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN “PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, FAZA I DHE II” NË BASHKINË E SHKODRËS**

Zona kadastrale 1965 Faza I

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe tokë arë m <sup>2</sup>	Çmimi në lekë/m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Mark Mhill Pjetri	256/33	1440	374	538560	certifikatë pronësie
2	Mhill Kole Pjetri	256/35	1050	374	392700	certifikatë pronësie
3	Fran Kole Pjetri	256/37	1905	374	712470	certifikatë pronësie
<b>TOTALI</b>			<b>4 395</b>		<b>1 643 730</b>	

Zona kadastrale 1965 Faza II

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe tokë arë m <sup>2</sup>	Çmimi në lekë/m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Vatë Nik Boshi	256/39	910	374	340340	certifikatë pronësie
2	Gjovalin Rrok Vukelaj	256/31	1320	374	493680	certifikatë pronësie
3	Nazije Et'hem Mehmetaj	256/39	1959	374	732666	certifikatë pronësie
4	Kujtim Ali Mehmetaj					
5	Arben Ali Mehmetaj					
6	Shpëtim Ali Mehmetaj					
<b>TOTALI</b>		<b>4 189</b>			<b>1 566 686</b>	

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për fazën I, për sipërfaqen 4 395 (katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, tokë arë, në vlerën 1 643 730 (një milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë;

b) Për fazën II, për sipërfaqen 4 189 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, tokë arë, në vlerën 1 566 686 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 210 416 (tre milionë e dyqind e dhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Shkodrës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit: “Zgjerimi i varrezave publike”, fazat I dhe II, në Bashkinë e Shkodrës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 8 584 (tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) m<sup>2</sup>, tokë arë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 205, datë 9.4.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA HAPJA DHE NDËRTIMI I UNAZËS VERIORE, SEGMENTI A-B NË LAGJEN "11 NËNTORI", HAPJA DHE SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË UNAZËS SË BRENDSHME, SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN "28 NËNTORI" ME RRUGËN "RINIA", SI DHE HAPJA E SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË RRUGËS "LEF NOSI", LAGJJA "5 MAJI", SEGMENTI B-C, TË BASHKISË SË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe ndërtimi i unazës veriore, segmenti A-B në lagjen "11 Nëntori", hapja dhe sistemimi i zgjatimit të unazës së brendshme, segmenti që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", hapja dhe sistemimi i zgjatimit të rrugës "Lef Nosi", lagjja "5 Maji", segmenti B-C", të Bashkisë së Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për sipërfaqet 1 595.4 (një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë katër) m<sup>2</sup>, truall, dhe 799.56 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup>, banesë, në segmentin A-B, në lagjen "11 Nëntori", në vlerën 50 263 894.4 (pesëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë;

b) Për sipërfaqet 1 278.55 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, truall, dhe 99.3 (nëntëdhjetë e nëntë pikë tre) m<sup>2</sup>, banesë, në segmentin që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", në vlerën 15 251 225.9 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e pesë pikë nëntë) lekë;

c) Për sipërfaqet 556.28 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e tetë) m<sup>2</sup>, truall, dhe 549.25 (pesëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e pesë) m<sup>2</sup>, banesë, në segmentin B-C, në lagjen "5 Maji", në vlerën 27 295 701.7 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një pikë shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 92 810 822.05 (nëntëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dhjetë mijë e tetëqind e njëzet e dy pikë zero pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale përballohet nga Bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

7. Regjistrimi i ri i pasurive për sipërfaqet 1 595.4 m<sup>2</sup>, truall, dhe 799.56 m<sup>2</sup>, banesë, për segmentin A-B në lagjen "11 Nëntori", sipërfaqet 1 278.55 m<sup>2</sup>, truall, dhe 99.3 m<sup>2</sup>, banesë, për segmentin që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", dhe sipërfaqet 556.28 m<sup>2</sup>, truall, dhe 549.25 m<sup>2</sup>, banesë, për segmentin B-C në rrugën "Lef Nosi", lagjja "5 Maji", të Bashkisë së Elbasanit, të bëhet në favor të kësaj bashkie.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objekteve në Bashkinë e Elbasanit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR EFEKT TË HAPJES SË UNAZËS SË BRENDSHME SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN “28 NËNTORI” ME RRUGËN RINIA” NË BASHKINË E ELBASANIT**

Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. Pasuri	Vërtetim pronësie m <sup>2</sup>			Sip. truall shpronësim	Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Shpronësim truall lekë	Sip. banesë m <sup>2</sup>		Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Shuma lekë Shpronësim banesë	Sip. e njësisë m <sup>2</sup>		Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Shuma lek shpronësim njësi	Shpronësim dru frutorë lekë	Shuma shpronësim lekë
			truall	banesë	njësi				preket	shpronësim			preket	shpronësim				
1	Gazmend Faslli Selimaj	6/362	49.6	0	49.6	49.6	5583	276916.8	0	0	0	0	49.6	49.6	68217	3383563.2	0	3660480
2	Oktavian Jani Gjoni Vangjel Jani Gjoni Lumnie Jani Gjoni	6/104	1180	99.3	0	743.45	5583	4150681.35	99.3	99.3	43617	4331168.1	0	0	0	0	287150	8768999.45
3	Demir Kamer Hyskja	6/447	794	99.2	0	485.5	5583	2710546.5	0	0	0	0	0	0	0	0	111200	2821746.5
						<b>1278.55</b>		<b>7138144.65</b>				<b>4331168.1</b>				<b>3383563.2</b>	<b>398350</b>	<b>15251225.95</b>

**TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT TË FAMILJEVE PËR EFEKT TË ZGJATIMIT TË RRUGËS “LEF NOSI: LAGJJA “5 MAJ” (SEGMENTI NGA KRYQËZIMI ME RRUGËN “IBRAHIM DINÇI” DERI NË BASHKIMIN ME UNAZËN VERIORE SEGMENTI “B-C”**

Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. i pasurisë	Vërtetim pronës.		Sip. truall m <sup>2</sup> shpronësohet	Vlera lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Sip. banesë m <sup>2</sup>		Vlera lekë/m <sup>2</sup>	Shuma lekë shpron. banesë	Dru frutor lekë	Shuma shpronësim, banesë+truall+dru	Vërejtje
			truall	banesë				preket	shpronës					
1	Adem Sali Shabani	13/204	258.6	211.9	149	13235	1972015	18.11	18.11	35965	651326.15	68000	2691341.15	ndërtesë 2-katëshe
2	Çelo Mustafa Çelaj	13/114	0	80.6	0	13235	0	80.6	80.6	35965	2898779	0	2898779	vetëm ndërtesë pa truall
3	Fuat Nexhip Merolli	13/105	367.31	70.75	28	13235	370580	0	0	35965	0	19500	390080	vetëm truall
4	Ramazan Qazim Zelli	13/137	0	66.5	0	13235	0	66.5	66.5	35965	2391672.5	0	2391672.5	vetëm ndërtesë pa truall
5	Agim Mahmut Likrama	13/138	0	71	0	13235	0	71	71	35965	2553515	0	2553515	vetëm ndërtesë pa truall
6	Petro Anastas Topi	13/201	286.9	72.5	120.66	13235	1596935.1	21.92	72.5	35965	2607462.5	74000	4278397.6	
7	Bardhull Daut Vaska	13/406	268.7	77.8	110.86	13235	1467232.1	52	52	35965	1870180	17700	3355112.1	
8	Kujtim Daut Vaska	13/407	69	13.37	0.76	13235	10058.6	0.76	13.36	35965	480852.05	0	490910.65	
		13/408	39.9	17.18	23.9	13235	316316.5	13.4	17.18	35965	617878.7	0	934195.2	
9	Durim Refat Dyrma	13/139	0	53.7	0	13235	0	53.7	53.7	35965	1931320.5	0	1931320.5	vetëm ndërtesë pa truall
10	Eduard Haxhi Koshi	13/178	160.4	51.4	67.5	13235	893362.5	18.8	51.4	35965	1848601	0	2741963.5	
11	Muhamet Isak Duka	13/179	98.4	52.9	55.6	13235	735866	17.6	52.9	35965	1902548.5	0	2638414.5	në proces legalizimi
						<b>556.28</b>	<b>7362366</b>			<b>549.25</b>	<b>19754136</b>	<b>179200</b>	<b>27295701.7</b>	

TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT TË FAMILJEVE PËR EFEKT HAPJES UNAZËS VERIORE, SEGMENTI “A-B”,  
LAGJJA “11 NËNTORI” ZK 8525

Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. i pasurisë	Vërtetim pronës.		Sip. truallit m <sup>2</sup> që shpronësohet	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Shpronës. truall		Sip. banesës m <sup>2</sup>		Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Shpron. banese		Drufrutorë Vlera lekë	Shuma e shpronësimit, lekë
			truall	banesë			Vlera lekë	preket	shpronës.	Vlera lekë					
1	Dhimitraq Filip Hasa	11/76	336.7	131.7	51.85	13235	686234.75	0	0	0	0	0	38400	724634.75	
2	Tomorr Filip Hasa Margarita Todi Hasa Kristina Filip Hasa Agim Filip Hasa	11/15	1458.42	247.85	458.28	13235	6065335.8	159.55	247.85	35965	8913925.25	82700	15061961.05		
3	Nikollaq Filip Hasa Kostandin Filip Hasa	11/64	276	116.6	183.53	13235	2429019.55	116.6	116.6	35965	4193519	0	6622538.55		
4	Kalije Kostandin Hasa Edmond Lefi Hasa	11/9	305	88.8	204.74	13235	2709733.9	66.5	88.8	35965	3193692	22100	5925525.9		
5	Nazmije Ibrahim Rama Shqiponja Xhaferr Rama Arjan Xhaferr Rama	11/63	40.7	40.7	40.7	13235	538664.5	40.7	40.7	35965	1463775.5	0	2002440		
6	Arif Selim Rama	11/68	41	41	41	13235	542635	41	41	35965	1474565	0	2017200		
7	Shpetim Selim Rama	11/67	53.8	53.8	53.8	13235	712043	53.8	53.8	35965	1934917	0	2646960		
8	Eduard Nikolla Ranxha	11/51	0	90	0	0	0	60	90.79	35965	3265262.35	0	3265262.35		
9	Mersin Sherif Rama	11/78	0	63.62	295.00	13235	3904325	48	63.62	35965	2288093.3	118000	6310418.3		
10	Ali Rama	11/74	0	56.47	266.5	13235	3527127.5	18	56.4	35965	2028426	131400	5686953.5		
					0		<b>21115119</b>				<b>28756175.4</b>	<b>392600</b>	<b>50263894.4</b>		

**VENDIM**  
**Nr. 206, datë 9.4.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,  
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË  
PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT  
“FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-  
KAVAJË (NGA PUSHPIMET E ÇERMËS,  
DEGËZIMI NË KAVAJË, DERI NË DEPON E  
RE, ARAPAJ, LOTI III)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë, deri në depon e re, Arapaj, loti III)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore me sipërfaqe 5 482 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme prej 1 858 229 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 197 000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 858 229 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, zëri “Investime”.

6. Shpronësimi të fillojë më 21.4.2014.

7. Pronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e planit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe, me nisjen e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së planit të objektit mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIME  
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

**FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË(NGA PUSHPIMET E CERMËS, DEGËZIMI NË KAVAJË  
DERI NË DEPON E RE ARAPAJ, LOTI III)**

Nr.				Nr. i pas	ARË			Shënime
1	Sabri	Kacmulli	1031	119/11	3701	339	1254605	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Ramazan	Kacmulli	1031	119/14	1781	339	603623	Konfirmuar nga ZRPP-ja
<b>SHUMA</b>					<b>5482</b>		<b>1858229</b>	



**VENDIM**  
**Nr. 209, datë 9.4.2014**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË SIGURISË NË ANIJE DHE PORTET E HAPURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 37 të ligjit nr. 168/2013 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të sigurisë në anije dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe organet që kryejnë aktivitet në portet detare për kontrollin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË SIGURISË NË ANIJE DHE PORTET E HAPURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit të Sigurisë, në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 168/2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”, si edhe vendosja e normave mbi bazën e të cilave ky organ do të kryejë dhe do të referojë veprimtarinë e tij në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

**Neni 2**  
**Statusi dhe krijimi i Komitetit Këshillimor**

1. Komiteti i Sigurisë në anije dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (më tej “Komiteti i Sigurisë”) është organ kolegjal dhe këshillimor.

2. Anëtarët e Komitetit të Sigurisë thirren në mbledhjen e tyre të parë nga drejtori ekzekutiv i Autoritetit Portual/drejtori i Portit, i cili është dhe kryetari i këtij organi.

**Neni 3**  
**Mbledhjet e Komitetit të Sigurisë**

1. Komiteti i Sigurisë mbledhet një herë në 3 muaj, konkretisht të enjten e fundit të çdo tremujori, ose ndonjë ditë tjetër të rënë dakord nga shumica e anëtarëve të Komitetit.

2. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i Komitetit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.

3. Komiteti mund të mbledhet më shpesh apo në raste të jashtëzakonshme (emergjente) me kërkesë me shkrim të:

a) kryetarit; ose

b) çdo anëtar i Komitetit të Sigurisë.

4. Mbledhjet e Komitetit të Sigurisë, si rregull, nuk bëhen të hapura, përveç rasteve kur vetë komiteti vendos ndryshe.

5. Mbledhjet drejtohen nga kryetari dhe, në raste të veçanta, nga zëvendësi i caktuar prej tij.

**Neni 4**  
**Vlefshmëria e mbledhjes**

1. Mbledhja e Komitetit të Sigurisë është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk është arritur ky kuorum, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër.

3. Anëtarët e Komitetit të Sigurisë do të njihen 5 (pesë) ditë përpara me tematikën dhe materialet e çdo mbledhjeje.

4. Çdo anëtar, me marrjen e njoftimit, duhet të jetë i pranishëm në mbledhjen e Komitetit.

**Neni 5**  
**Pjesëmarrës në mbledhje**

Sipas rastit dhe tematikave që do të trajtohen në një mbledhje, me miratimin e Komitetit, në mbledhje mund të marrin pjesë apo të jenë të ftuar, edhe:

a) Përfaqësues nga pushteti qendror dhe ai vendor;

b) Përfaqësues nga përfaqësitë dhe organizata të huaja ndërkombëtare;

c) Drejtues të Forcës së Sigurisë Portuale;

ç) Përfaqësues të punëmarrësve të Autoritetit Portual/portit detar;

d) Përfaqësues të subjekteve operatore në port;

dh) Përfaqësues të firmave tregtare dhe qiramarrëse, shoqatat tregtare;

e) Shërbimet e emergjencave;

ë) Palë të tjera që kanë lidhje me portin, sigurinë apo që kanë njohuritë teknike të nevojshme për të dhënë mendime në lidhje me çështjet që do të diskutohen.

#### Neni 6

### **Veprimtaria e Komitetit të Sigurisë**

1. Roli dhe veprimtaria e Komitetit të Sigurisë në fushën e sigurisë ka të bëjë me shkëmbimin e informacioneve, dhënien e mendimeve dhe rekomandimeve, lidhur me:

- a) Vlerësimin e sigurisë së portit;
- b) Projektplanet e sigurisë, me qëllim bashkërendimin e punës me palët operuese në port për zbatimin e këtyre planeve;
- c) Masat e sigurisë dhe procedurat për hyrjen në port sipas zonave, trajtimin e ngarkesave dhe bagazheve të pashoqëruara, furnizimin e anijeve me pajisje që përdoren nga ekuipazhi, mbështetur në Kodin ISPS, pika 16 e vijues.

#### 2. Ky Komitet:

- a) Këshillon organet përkatëse për zbatimin e planit të sigurisë së portit;
- b) Ndikon në vlerësimin e sigurisë së portit;
- c) Bashkërendon, komunikon dhe lehtëson zbatimin e masave përkatëse të sigurisë, që kërkohen nga plani i sigurisë;
- ç) Jep informacion sqarues për zbatimin, ushtrimet, stërvitjet, kontrollet, trajnimet për sigurinë dhe përputhjen periodike të planit të sigurisë së portit.

#### Neni 7

### **Të drejtat dhe detyrat e kryetarit të Komitetit**

Kryetari i Komitetit të Sigurisë ka këto të drejta dhe detyra:

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, kryetari kërkon zyrtarisht përcaktimin e emrave të përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrëse në Komitetin e Sigurisë;
2. Thërret anëtarët e Komitetit në mbledhjen e tyre të parë dhe, në raste të jashtëzakonshme, thërret me shkrim dhe organizon mbledhje urgjente;
3. Në rastet kur nuk plotësohet numri i nevojshëm i anëtarëve, cakton një datë tjetër për zhvillimin e mbledhjes;
4. Drejton mbledhjet e Komitetit të Sigurisë dhe në pamundësi për të qenë prezent cakton një zëvendës për drejtimin e mbledhjes;
5. Propozon dhe u komunikon anëtarëve për çështje që do të trajtohen gjatë mbledhjes;
6. Në rastet kur një anëtar i Komitetit mungon pa arsye, për një kohë të gjatë në mbledhjet e planifikuara, kërkon zëvendësimin e këtij anëtar duke dhënë motivet e qarta;
7. Organizon punën për zgjedhjen e sekretarit;
8. Merr masa për të siguruar kushtet administrative dhe teknike për zhvillimin e mbledhjes;

9. Merr masa për plotësimin dhe depozitimin e protokollit të mbledhjes.

#### Neni 8

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komitetit të Sigurisë**

Anëtari i Komitetit të Sigurisë ka këto të drejta dhe detyra:

1. Të marrë pjesë në mbledhjet periodike dhe ato të jashtëzakonshme të Komitetit;
2. Të bashkëpunojë me kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Komitetit për krijimin e një vlerësimi sa më të qartë të situatës së sigurisë në porte;
3. Të propozojë çështje dhe problematika që mendon se duhet të trajtohen në mbledhjen e radhës;
4. Të propozojë dhe të rekomandojë masa për bashkëpunimin dhe koordinimin sa më të mirë të punës për përforcimin e sigurisë në port.

#### Neni 9

### **Të drejtat dhe detyrat e sekretarit**

Sekretari i Komitetit të Sigurisë zgjidhet me miratimin e shumicës së anëtarëve të Komitetit gjatë mbledhjes së parë dhe ka këto detyra:

1. Asiston për përgatitjen e materialeve të mbledhjes;
2. Mban procesverbalin gjatë zhvillimit të mbledhjeve;
3. Plotëson protokollin e mbledhjes dhe kujdeset për arkivimin e tij;
4. Zbardh rekomandimet e Komitetit të Sigurisë.

#### Neni 10

### **Protokolli i mbledhjes**

1. Në çdo mbledhje mbahet një protokoll, ku bëhet një përmbledhje e të gjitha diskutimeve që u trajtuan në mbledhje, data dhe vendi i saj, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, si dhe vendimet që u morën.
2. Protokollin mund t'i vihet në dispozicion çdo anëtar i Komitetit për ta lexuar, kur ai dëshiron këtë.
3. Në fund të çdo mbledhjeje, protokollin nënshkruhet nga sekretari dhe kryetari i Komitetit dhe depozitohet në arkivin e veçantë, të krijuar për këtë qëllim.

#### Neni 11

### **Efektet ligjore**

1. Sugjerimet, këshillat, konkluzionet dhe përfundimet e këtij Komiteti u prezantohen organeve përkatëse në formën e rekomandimeve me shkrim.
2. Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe të gjithë anëtarët e Komitetit të Sigurisë së Portit.

**VENDIM**  
**Nr. 210, datë 9.4.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË  
VENDIMIN NR. 1015, DATË 27.11.2013 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR  
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË  
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,  
PRONË PRIVATE, OBJEKTE, QË PREKEN NGA  
REHABILITIMI MJEDISOR I VIJËS SË  
MBROJTUR BREGDETARE UJË I FTOHTË-  
TUNELI, BASHKIA VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 1015, datë 27.11.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4 dhe 6, ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e ligjshëm të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 7 739,8 (shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë presje tetë) m<sup>2</sup>

**LISTA E PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA REHABILITIMI MJEDISOR I VIJËS SË MBROJTUR BREGDETARE UJË I FTOHTË-TUNELI, BASHKIA VLORË**

Nr.	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi mesatar l/m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Shënime
1	16/8+1-18	8602	55.05	57000	3137850	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	16/8+2-7	8602	62.76	57000	3577320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	16/8+1-7	8602	43.28	57000	2466960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	16/8+2-25	8602	97.32	57000	5547240	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	16/8+2-23	8602	79.17	57000	4512690	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	16/8+1-1	8602	47.59	57000	2712630	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	16/8+2-31	8602	62.76	57000	3577320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	16/8+2-21	8602	43.28	57000	2466960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	16/8+1-5	8602	71.44	57000	4072080	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	16/8+2-24	8602	46.35	57000	2641950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	16/8+2-17	8602	97.32	57000	5547240	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	16/8+1-12	8602	55.31	57000	3152670	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	16/8+2-9	8602	88.58	57000	5049060	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	16/8+2-33	8602	97.32	57000	5547240	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	16/8+2-22	8602	92.69	57000	5283330	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	16/8+2-16	8602	62.79	57000	3579030	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	16/8+2-30	8602	92.69	57000	5283330	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	16/8+1-20	8602	44.84	57000	2555880	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Pjesa e mbetur, bashkëpronarët e objektit	8602	6499.26	57000	370457820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	<b>TOTALI</b>		<b>7739.8</b>		<b>441,168,600</b>	

ndërtim, të vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 441 168 600 (katërqind e dyzet e një milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekësh.”.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 441 168 600 (katërqind e dyzet e një milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet, përkatësisht, 341 168 600 (treqind e dyzet e një milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 100 000 000 (njëqind milionë) lekë nga fondi i kontingjencës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit është data 30.4.2014.”.

2. Pas pikës 6, shtohet pika 6.1 me këtë përmbajtje:

“6.1 Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia Vlorë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**

**Nr. 213, datë 9.4.2014**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR PËRFAQËSIMIN E SHQIPËRISË NË BIENALEN E ARKITEKTURËS, QË DO TË MBAHET NË VENECIA, ITALI, NË PERIU DHËN 7.6.2014-23.11.2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, zëri 604, aparati “Projekte në art”, t’i shtohet fondi prej 7 740 900 (shtatë milionë e shtatëqind e dyzet mijë e nëntëqind) lekë, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të qirasë për përfaqësimin e Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës, që do të mbahet në Venecia, Itali, në periudhën 7.6.2014-23.11.2014.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës, deri në momentin e rimbursimit nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, në çastin e bërjes efektiv të tij.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

**VENDIM**

**Nr. 214, datë 9.4.2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 75, të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshijmish, për vitin 2014, lejohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve për mobilim zyresh. Në procedurat e prokurimit, përfshihen: lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**

**Nr. 4, datë 11.3.2014**

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT “GRAND/TRANSFERTË KORRENTE E BRENDSHME” PËR FEDERATAT SPORTIVE DHE KOMITETIN OLIMPIK SHQIPTAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të nenit 10/1 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 27.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave

**UDHËZOJNË:**

1. Për qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi, fonde “Grande/transfertë korrente e brendshme” janë fondet publike që akolokohen nga buxheti i shtetit për “Federatat sportive” dhe për Komitetin Olimpik Shqiptar.

2. Buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin, i detajuar në gr. 11, titulli 08140, artikulli 6040000 “Transferta korrente të brendshme”, detajohet nga ministria përgjegjëse për sportin në llogarinë e përfituesve/federatave shqiptare sportive dhe Komitetit Olimpik Shqiptar, në respekt të pavarësisë së tyre financiare, sipas kriterëve prioritarë dhe mënyrës së përdorimit të fondeve, të parashikuar në këtë udhëzim.

3. Kriteret prioritarë për përfitimin e fondeve buxhetore, janë si më poshtë:

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të trajtojë me prioritet në ndarjen e fondeve “Grand” ato federata

shqiptare të sportit, të cilat kanë epërsi në treguesit e mëposhtëm:

- Numri i të licencuarve të organizatës sportive;
- Numri i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Rezultatet e arritura nga skuadra apo individët në arenën ndërkombëtare;
- Përfshirje në projekte, të cilat demonstrojnë angazhimin e federatës së sportit në shkollë;
- Përfshirjen në projekte të personave me aftësi të kufizuar;
- Hartimin e programeve strategjike 4-vjeçare për zhvillimin e disiplinave sportive mbarëkombëtare;
- Të ardhura nga donacionet, licencimet apo çdo burim tjetër i ligjshëm;
- Kontribute nga federatat ndërkombëtare;
- Të ardhurat nga e drejta televizive.

4. Zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “Grand/transfertë korrente e brendshme” për federatat shqiptare sportive janë:

- a) Financimi i kontratave të punësimit, sipas mandatit të përcaktuar në statutin e federatës, për jo më shumë se 2 dy punonjës (përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm) në nivelin e pagës së një institucioni qendror/ministri, në kategorinë e pagës III-b dhe IV-a;
- b) Shpenzimet operative të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- c) Trajtimin ushqimor, në natyrë ose vlerë, të sportistëve të nivelit të lartë, si dhe pagesat e kontratave të shërbimit për trajnerët e ekipeve kombëtare, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- d) Grumbullimin stërvitor të ekipeve kombëtare;
- e) Sigurimin shëndetësor për sportistët e ekipeve kombëtare;
- f) Trajtimin mjekësor dhe shpenzimet e riaftësimit të sportistëve;
- g) Shpenzimet për pritje/përcjellje delegacionesh, konferenca, çmime etj., në nivelin e lejuar nga legjislacioni në fuqi;
- h) Shpërblimin për arritjen e rezultateve të larta sportive;
- i) Blerjen e bazës materiale/uniforma sportive etj.;
- j) Shpenzime për kërkimin dhe kualifikimin shkencor në sport.

5. Zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “Grand/transfertë korrente e brendshme” për Komitetin Olimpik Shqiptar, janë si më poshtë:

- a) Financimi i kontratave të punësimit, për jo më shumë se 4 persona me nivelin e pagës së një institucioni qendror/ministri, në kategoritë respektive të pagës II-b për Sekretarin e Përgjithshëm, në përputhje me mandatin e përcaktuar në statutin e Komitetit Olimpik dhe IV-a për 3 specialistët e këtij institucioni, për sigurimin e funksionimit administrativ dhe mbarëvajtjen e punës së Komitetit Olimpik Kombëtar;

- b) Financimin/bashkëfinancimin e shpenzimeve operative, në varësi edhe me të ardhurat nga burime të tjera në dispozicion, për mbështetjen e sportistëve elitare, ekipeve kombëtare olimpike për sportet verore dhe dimërore.

6. Përfituesit e fondeve “Grand/transfertë korrente e brendshme” do të paraqesin në MAS dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Brenda datës 15 gusht të vitit korrent, projekt-programin afatmesëm, në përputhje me formatin e aplikimit të miratuar nga Ministria e Financave për buxhetin afatmesëm;

- b) Brenda 15 ditësh nga njoftimi zyrtar i përfitimit të grandit, planin e detajuar të përdorimit të fondeve në dispozicion të përfituesit për vitin korrent (për fondet publike dhe të ardhurat e tjera nga burime të ligjshme);

- c) Planin e detajuar të përdorimit të fondeve, i cili duhet të përmbajë detyrimisht objektivat konkretë që do të arrihen/synohen të arrihen, si edhe programet e zhvillimit të disiplinës sportive apo funksionit të organizatës;

- d) Kopje të vendimit të komitetit drejtues të përfituesve, për ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike. Një kopje të dërgohet, gjithashtu, edhe në Ministrinë e Financave për t’u regjistruar në sistemin elektronik të thesarit;

- e) Deklarimin e të ardhurave nga të gjitha burimet e ligjshme, si të ardhurat nga licencimet, donacionet, e drejta televizive, shitja e biletave dhe çdo e ardhur tjetër.

7. Kohëzgjatja e kontratës së punësimit për punonjësit që financohen me fondet e grandit/transfertës, nuk mund të jetë më e gjatë se mandati i përcaktuar në statutin e organizatës që përfiton fonde publike, sipas këtij udhëzimi.

8. Drejtoria përgjegjëse për sportin shqyrton dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve, sa më sipër, dhe propozon ndarjen e fondeve publike sipas institucioneve përfituese. Drejtoria e Financave bën detajimin e fondeve buxhetore sipas organizatave, referuar propozimit të Drejtorisë së Sportit dhe fondeve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit.

9. Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financës monitorojnë përdorimin e fondeve publike nga përfituesit e grandit/transfertës.

10. Federatat sportive duhet të bëjnë transparente për anëtarët e tyre, ndarjen e të gjitha fondeve të përfituara në vitin korrent, si dhe ta publikojnë këtë informacion në *web-sit*-et e çdo organizate. Drejtoria e Sportit monitoron zbatimin e këtij detyrimi.

11. Ministri përgjegjës për sportin ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e dhënies së grandit apo ndryshimin e destinacionit të tij, nëse konstatohet se nuk zbatohen kërkesat e këtij udhëzimi, ose për arsye/shkaqe të tjera të motivuara.

12. Pasqyrat financiare të përfituesve të fondeve “Grand/transfertë korrente e brendshme”, depozitohen

në ministrinë përgjegjëse për sportin, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave, referuar ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pasqyrat financiare duhet të jenë hartuar dhe certifikuar konform ligjit dhe të përfshijnë dhe të raportojnë të gjitha të ardhurat nga burimet e ligjshme, si dhe të gjitha përdorimet/shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor.

13. Në zbatim të këtij udhëzimi, çdo përfitues i fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme”, të hartojë rregulloren e brendshme të përdorimit të tij.

14. Federatat shqiptare të sportit mund të aplikojnë me projekte, apo të kërkojnë financime për investime/shpenzime kapitale nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për programin “Zhvillimi i sportit”, për objekte në pronësi publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave.

16. Udhëzimi nr. 1, datë 8.2.2002 “Për mënyrën e financimit të cilësisë sportive”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

**Shkëlqim Cani**

MINISTRI I ARSIMIT

**DHE SPORTIT**

**Lindita Nikolla**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006